

**R E F E R A T**  
**PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI PËR LËNDËT**

**1. E DREJTA NDËRKOMBËTARE PRIVATE**  
**2. E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE DHE E DREJTA E LUFTËS**

**NË FAKULTETIN JURIDIK NË UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Në lidhje me konkursin për zgjedhje të mësimdhënësve në Universitetin e Tetovës të datës 06.10.2020, të shpallur në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” dhe në ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët:

1. E drejta ndërkombëtare private dhe  
2. E drejta ndërkombëtare humanitare dhe e drejta e luftës  
në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, me Propozim të Këshillit Mësimor - Shkencor të Fakultetit Juridik nr 13-1181/5 të datës 17.11.2020 formohet Komisioni recensues në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Ylber Sela, kryetar**
- 2. Prof. Dr. Bujar Ahmedi, anëtar**
- 3. Prof. Dr. Drita M. Fazlia, anëtar**

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me konkursin e lartpërmendur dhe në përputhje me nenin 132 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr 82/2018), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës këtë:

**RECENSION**

Në konkursin e datës 06.10.2020, të shpallur në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” dhe në ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët 1. E drejta ndërkombëtare private dhe 2. E drejta ndërkombëtare humanitare dhe e drejta e luftës, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, **u paraqit kandidati i vetëm Dr. Njomza Selimi Osmani.**

**I. BIOGRAFI E SHKURTËR**

**a. Arsimimi**

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja Dr. Njomza Selimi Osmani është lindur në Gostivar ku dhe e kryen me sukses të shkëlqyeshëm shkollimin fillor dhe të mesëm, duke u dalluar si nxënëse e gjeneratës. Në vitin 2002 regjistrohet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Europës Juglindore, të cilin e përfundon në vitin 2006 me notë mesatare 9.6 si studente e dalluar dhe fiton **titullin Juriste e diplomuar.**

Pas përfundimit të studimeve deri-diplomike, kandidatja Dr. Njomza Selimi Osmani rregjistrohet në studime të magjistraturës në Fakultetin Juridik “Justiniani I” në Shkup, në drejtimin “E drejta ndërkombëtare dhe politika ndërkombëtare, të cilat i kryen me sukses me notë mesatare 9.3. Me temën “E drejta e vetëvendosjes: ndarja e pushtetit”, në mentorim të Prof.Dr. Ljubomir D. Frckoski në maj të vitit 2011 mbron tezën e magjistraturës dhe fiton titullin shkencor **Magjistre e shkencave juridike - drejtimi e drejta ndërkombëtare dhe politika ndërkombëtare.**

Pas përfundimit të studimeve të magjistraturës Njomza Selimi Osmani vijon studimet e doktoraturës në Fakultetin Juridik “Justiniani I” në Shkup. Me temën “Standardet ndërkombëtare për të drejtën e votës dhe përfaqësimin politik të grave”, në mentorim të Prof.Dr. Ljubomir D. Frckoski, para anëtarëve tjerë të komisionit në përbërje Prof. Dr. Sasho Georgievski – kryetar, prof. Dr. Tatjana Petrushevska, prof. Dr. Elena Mihajlova Stratilati dhe doc. Ilina Cenevska mbron tezën e doktoraturës më 21.01.2020 dhe fiton gradën shkencore **“Doktor” në të drejtën ndërkombëtare.**

### **b. Angazhimi si ligjëruese**

Kandidatja Dr. Njomza Selimi Osmani, në vitin 2010 angazhohet si asistent i ri në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, ku mbulon ligjeratat dhe ushtrimet në lëndën: Legjislacioni në arsim dhe demokratizimi i shkollës. Duke filluar nga viti 2011, kandidatja angazhohet fillimisht si asistent dhe duke filluar nga viti 2016 edhe si asistent doktorant në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Tetovës ku mbulon ligjerata dhe/ose ushtrimet në lëndët: E drejta ndërkombëtare private, E drejta ndërkombëtare publike, Marrëdhëniet ndërkombëtare, Sociologjia juridike, Filozofia e së drejtës, Historia e shtetit dhe së drejtës, Historia nacionale e të drejtës, E drejta e Unionit Evropian, Komunikim dhe marrëdhëniet me publikun, E drejta ekologjike.

## **II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE**

Kandidatja Dr. Njomza Selimi Osmani, gjatë kësaj periudhe merret me publikime në fushën e ekspertizës së saj profesionale. Ka publikuar këto punime:

1. Selimi Osmani, Njomza, (2020), “Impakti i sistemeve zgjedhore në përfaqësimin politik të grave”, Revista ndërkombëtare shkencore “Centrum” nr. 13/2020, fq. 303-315, ISSN: 1857-8640 (verzioni i printuar) ISSN: 1857-9396 (verzioni online)
2. Selimi Osmani, Njomza, (2020), “Rritja e përfaqësimit politik të grave përmes sistemit të kuotave”, Revista ndërkombëtare shkencore “Centrum” nr. 14/2020, fq.
3. Selimi Osmani, Njomza, (2020), “Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi nën prizmën e Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Revista e shkencave shoqërore “Vizione” nr. 35, fq. 79-87, ISSN: 1409-8962 (verzioni i printuar), ISSN: 1857-9221 (verzioni elektronik)

4. Selimi Osmani, Njomza, (2020), “Strengthening women’s political participation: Political party recruitment and electoral systems”, Revista e shkencave shoqërore “Vizione” nr. 35, fq. 121-132, ISSN: 1409-8962 (verzioni i printuar), ISSN: 1857-9221 (verzioni elektronik)

#### **4. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe të tjera**

Në mes tjerave kandidatja ka marrë pjesë edhe në këto konferenca:

1. 13-15 nëntor 2019, Tetovë  
Konferenca ndërkombëtare shkencore “Perspektiva evropiane e Ballkanit perëndimor”, Fakulteti juridik, Universitetit i Tetovës
2. 25 – 26 maj 2006, Selanik, Greqi  
Konferenca studentore “Ballkani pas 10 viteve – Imagjino!” organizuar nga Fondi memorial “Borjan Tanevski”
3. 9 - 10 mars 2006, Kluzh Napoka, Rumani  
Konferenca “Demokracia në shoqëritë multietnike”, organizuar nga Qendra resurse për dallime etnokulturore, Rumani
4. 9 - 29 janar 2006 – Mynih, Gjermani  
Trajnim për gjuhën dhe kulturën gjermane, organizuar nga DAAD
5. 28 shtator – 6 tetor 2004 – Varshavë, Poloni  
Trajnim rajonal mbi avokimin për të drejtat e njeriut organizuar nga Grupi ndërkombëtar për të drejtat e pakicave Londër, si dhe pjesëmarrje në Takimin e OSBE-së për implementim të dimensionit njerëzor
6. 23 - 27 tetor 2003 – Strazburg, Francë  
  
ELENA Kurs ndërkombëtar për rëndësinë e Konventës evropiane për të drejtat e njeriut mbi të drejtën në azil (organizuar nga ECRE me përkrahje të Këshillit të Evropës)

### **III. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE**

1. Mbajtja e mësimit (ushtrime dhe ligjërata)

Kandidatja Dr. sc. Njomza Selimi Osmani ka kontinuitet në përvojën e saj universitare. Pas diplomimit, duke filluar nga viti 2010, është kyçur në procesin arsimor në nivel universitar. Duke filluar nga viti 2010 deri në vitin 2016 në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Tetovës ka punuar part time si asistent, ndërsa në nëntor të vitit 2016 pranohet në marrëdhënie pune si asistent doktorant në fushën e të drejtës ndërkombëtare.

Kandidatja Dr. Njomza Selimi Osmani, rregullisht, në të dy semestrat të çdo viti akademik, ka mbajtur ligjërata dhe ushtrime në Universitetin e Tetovës edhe atë në Tetovë dhe disperzime në Shkup. Gjatë periudhës së angazhimit si asistent part-time në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës ka mbajtur ligjërata (nën mentorim) në lëndët: Legjislacioni në

arsim dhe demokratizimi i shkollës, Marrëdhëniet ndërkombëtare, Filozofia e së drejtës dhe ushtrime në lëndët: Legjislacioni në arsim, Historia e shtetit dhe së drejtës, Historia nacionale e së drejtës, E drejta ndërkombëtare private, E drejta ndërkombëtare publike, Sociologjia e së drejtës.

Gjatë periudhës së angazhimit si asistent doktorant, kandidatja ka mbajtur ligjerata (nën mentorim) dhe ushtrime në lëndët: Marrëdhëniet ndërkombëtare, Të drejtat e njeriut, Komunikim dhe marrëdhëniet me publikun, si dhe ushtrimet në lëndët: E drejta e Unionit europian.

## 2. Mentorim në mësim praktik

Kandidatja nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Tetovës ka qenë e caktuar mentor për mësim praktik të studentëve të vitit të tretë në Komunën e Gostivarit organizuar në vitet akademike 2013/2014 dhe 2014/2015.

## **IV. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË**

### **Angazhime shtesë:**

1. Sekretar i Komisionit Komunal Zgjedhor Gostivar (2009)
2. Anëtare e Komisionit Komunal Zgjedhor Gostivar (2011-2017)
3. Anëtare e Këshillit drejtues në Cerdhen “Gëzimi fëmijëror” Gostivar (2005-2009)
4. Anëtare e Këshillit drejtues në NP “Parkingjet publike dhe gjelbërimi” Gostivar (2015-2017)

### **Udhëheqës:**

1. Udhëheqëse e Klinikës juridike pranë Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës (2019 – në vazhdim)
2. Udhëheqëse e Sektorit juridik në Komunën e Gostivarit (2014-2016)
3. Udhëheqëse e Departamentit për resurse njerëzore në Komunën e Gostivarit (2008-2009)

## **VLERËSIM DHE PROPOZIM**

Në bazë të konstatimeve të lartpërmendura, Komisioni recensues vlerëson se kandidatja **Dr. Njomza Selimi Osmani**, i plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe të tjera për zgjedhje në thirrje mësimore *Docent*.

Kandidatja Dr. Njomza Selimi Osmani ka arsimimin e duhur, ka publikime shkencore të mjaftueshme, ka përvojë në fushën akademike, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe projekte hulumtuese. Në bazë të kësaj, Komisioni konstaton se Dr. Njomza Selimi Osmani, i plotëson të gjitha kushtet për thirrje mësimore *DOCENT*, të parapara në nenin 172-175 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr 82/2018), Statutin e Universitetit të

Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës.

Komisioni recensues, ka nderin t'i propozojë Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që **Dr. Njomza Selimi Osmani**, të zgjidhet mësimdhënës me thirrje mësimore-shkencore *DOCENT* për lëndët:

- 1. E drejta ndërkombëtare private**
- 2. E drejta ndërkombëtare humanitare dhe e drejta e luftës.**

**Tetovë, 2020**

**Komisioni recensues**

**1. Prof. Dr. Ylber Sela, kryetar**

---

**2. Prof.Dr. Bujar Ahmedi, anëtar**

---

**3. Prof. Dr. Drita M. Fazlia, anëtar**

---

**S H T O J C Ë**  
**PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE-RIZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-  
 SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE**

**KANDIDATI: NJOMZA SELIMI OSMANI**

**INSTITUCIONI: FAKULTETI JURIDIK, UNIVERSITETI I TETOVËS**

**LËNDËT: 1. E DREJTA NDËRKOMBËTARE PRIVATE  
 2.E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE DHE  
 E DREJTA E LUFTËS**

**TITULLI: DOCENT**

**VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE**

Nr. rendor	EMRI I AKTIVITETIT	Pikët
<b>1.</b>	<b>Mbajtja e ligjeratave</b>	
1.1	Legjislacioni në arsim dhe demokratizimi i shkollës (Fakultetit pedagogjik)	2x15x5x0.04=6
1.2	Marrëdhënie ndërkombëtare	2x15x8x0.04=9.6
1.3	Filozofia e së drejtës	2x15x1x0.04=1.2
1.4	Të drejtat e njeriut- Fakulteti pedagogjik	2x15x2x0.04=2.4
1.5	Komunikim dhe marrëdhënie me publikun	2x15x5x0.04=6
1.6	E drejta ekologjike	2x15x1x0.04=1.2
<b>2.</b>	<b>Ushtrime</b>	
Organ hhdjuh	Legjislacioni në arsim dhe demokratizimi i shkollës (Fakultetit pedagogjik)	2x15x5x0.03=4.5
Marrëdhënie n	Marrëdhënie ndërkombëtare	2x15x9x0.03=8.1
Histori Hi His	Historia e shtetit dhe së drejtës	4x15x3x0.03=5.4
Historia e së dr	Historia nacionale e shtetit	4x15x3x0.03=5.4
2.5	E drejta ndërkombëtare private	2x15x2x0.03=1.8
	E drejta ndërkombëtare publike	4x15x4x0.03=7.2
2.7	Sociologjia e së drejtës	4x15x3x0.03=5.4
2.8	Të drejtat e njeriut- Fakulteti pedagogjik	2x15x2x0.03=1.8
2.9	E drejta e Unionit Evropian	2x15x3x0.03=2.7
2.10	E drejta ekologjike	2x15x1x0.04=1.2
<b>3.</b>	<b>Mentorim në mësim praktik</b>	
3.1	Mentorim të studentëve të vitit të tretë të Fakultetit Juridik në Komunën e Gostivarit, 2014 dhe 2015	2x1=2
	<b>Gjithsej</b>	<b>71.9</b>

**VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE**

Nr. Rendor	EMRI I AKTIVITETIT	Pikët
<b>1.</b>	<b>PJESËMARRJA NË KONFERENCA SHKENCORE DHE SIMPOZIUME NACIONALE DHE NDËRKOMBËTARE</b>	
1.1	Konferenca ndërkombëtare shkencore “Perspektiva evropiane e Ballkanit perëndimor”, Fakulteti juridik, Universitetit i Tetovës, 2019	3.0
1.2.	Konferenca studentore “Ballkani pas 10 viteve – Imagjino!” organizuar nga Fondi memorial “Borjan Tanevski, Selanik 2006	3.0
1.3.	Konferenca “Demokracia në shoqëritë multietnike”, organizuar nga Qendra resurse për dallime etnokulturore, Cluj Napoca, Rumani, 2006	3.0
1.4.	Trajnim për gjuhën dhe kulturën gjermane, organizuar nga DAAD, Mynih, Gjermani, 2006	3.0
1.5.	Trajnim rajonal mbi avokimin për të drejtat e njeriut organizuar nga Grupi ndërkombëtar për të drejtat e pakicave Londër, si dhe pjesëmarrje në Takimin e OSBE-së për implementim të dimensionit njerëzor, Varshavë, Poloni, 2004	3.0
1.6.	ELENA Kurs ndërkombëtar për rëndësinë e Konventës evropiane për të drejtat e njeriut mbi të drejtën në azil (organizuar nga ECRE me përkrahje të Këshillit të Evropës) , Strazburg, Francë, 2003	3.0
1.7	International Conference, <i>Universality, Globalization and the Rule of Law</i> , organized by State University of Tetova	3.0
1.8	3-rd International Scientific Conference of the Faculty of Law, organized by State University of Tetova	3.0
1.9	Uorkshop, Electoral Systems Module, organized by Bridge ( Building Resources in Democracy, Governance and Elections	3.0
1.10	Kurs rajonal për “Përkrahjen e monitorimit dhe dokumentimit të aftësive të OJQ-ve për të drejtat e njeriut dhe institucionet e rajonit HURIDOCS” organizuar nga Qendra shqiptare për të drejta të njeriut, Tiranë 2004	3.0
	Konferenca e Katërt Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Juridik: Sfidat e sigurisë dhe standardet universal në procesin integrues Euroatlantik, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 17 dhe 18 Nëntor 2017	3.0
1.11	Konferenca e Tretë Ndërkombëtare Shkencore e	3.0

	Fakultetit Juridik: Drejtësia dhe sfidat e proceseve euro-atlantike, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 18 dhe 19 Nëntor 2016	
	<b>PUNIME SHKENCORE/PROFESIONALE, TË PUBLIKUARA NË KONFERENCA NDËRKOMBËTARE ME PROCEEDINGS ME BORD REDAKTUES NDËRKOMBËTAR, NË REVISTA NDËRKOMBËTARE SI DHE NË REVISTA ME IMPAKT FAKTOR</b>	
<b>3</b>	<b>ARTIKUJ ME REZULTATE ORIGJINALE</b>	
3.1.	Selimi Osmani, Njomza, (2020), “Impakti i sistemeve zgjedhore në përfaqësimin politik të grave”, Revista ndërkombëtare shkencore “Centrum” nr. 13/2020, fq. 303-315, ISSN: 1857-8640 (verzioni i printuar) ISSN: 1857-9396 (verzioni online)	6.0
3.2.	Selimi Osmani, Njomza, (2020), “Rritja e përfaqësimit politik të grave përmes sistemit të kuotave”, Revista ndërkombëtare shkencore “Centrum” nr. 14/2020, fq.	6.0
3.3.	Selimi Osmani, Njomza, (2020), “Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi nën prizmen e Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Revista e shkencave shoqërore “Vizione” nr. 35, fq. 79-87, ISSN: 1409-8962 (verzioni i printuar), ISSN: 1857-9221 (verzioni elektronik)	6.0
3.4.	Selimi Osmani, Njomza, (2020), “Strengthening women’s political participation: Political party recruitment and electoral systems”, Revista e shkencave shoqërore “Vizione” nr. 35, fq. 121-132, ISSN: 1409-8962 (verzioni i printuar), ISSN: 1857-9221 (verzioni elektronik)	6.0
3.5.	Driton Kuqi, Njomza Selimi Osmani, <i>Constitutional-legal engineering model of democracy in North Macedonia</i> , in Justicia	6.0
	<b>Gjithsej</b>	<b>66</b>

## VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË

Nr. Rendor	EMRI I AKTIVITETIT	Pikët
1	Vizitë studimore në Fakultetin Juridik- Universiteti i Sarajevës, Norvegji	1.0
2	Udhëheqëse e Sektorit juridik në Komunën e Gostivarit	3.0
3	Udhëheqëse e Departamentit për resurse njerëzore në Komunën e Gostivarit	3,0



4	Koordinatore e Klinikës juridike në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës	3.0
5	Sekretar i Komisionit komunal zgjedhor Gostivar	3.0
6	Anëtare në Komisionin komunal zgjedhor Gostivar	3.0
7.	Anëtare në këshillin drejtues të IPSHV Cerdhja “Gëzimi fëmijëror” Gostivar	3.0
8.	Anëtare në këshillin drejtues në NP “Parkingjet” në Gostivar	3
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>19</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>71.9</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>66</b>
<b>VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË</b>	<b>19</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>156.9</b>

Tetovë, 2020

**Komisioni recensues**

**1. Prof. Dr. Ylber Sela, kryetar**

\_\_\_\_\_

**2. Prof. Dr. Bujar Ahmedi, anëtar**

\_\_\_\_\_

**3. Prof. Dr. Drita M. Fazlia, anëtar**

\_\_\_\_\_